




REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 051/18

Nr. i fq. / Br. st - 1 -

Data: / Datum 15. 01. 2018

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 45.1 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 6.3 të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës dhe organeve të tij, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

I u f t o n

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më **25 janar 2018 (e enjte)** me fillim në ora 10:00. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtrri.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës i datës 28.09.2017;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja inauguruese e kuvendit i datës 20.12.2017;
3. Shqyrtimi i Draft-planit të punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2018;
4. Shqyrtimi i Draft-planit të punës të kryetarit të komunës për vitin 2018;
5. Shqyrtimi i Raportit tremujor mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;
6. Shqyrtimi i Planit të veprimit mbi rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm;
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
8. Shqyrtimi i propozimeve për formimin e komisionit për ndarjen e bursave për studentë dhe shpërblime për nxënës;
9. Të ndryshme.

Bashkëngjitur me ftesë iu dërgojmë materialet për pikat e rendit të ditës, kurse për pikat 7 dhe 8 të rendit të ditës, materialet nuk janë dërguar pasi që emrat e anëtarëve të këtyre komisioneve do të propozohen dhe aprovohen nga ana e kuvendit.

Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -VIII- (E TETË) E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS
SË VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 28 SHTATOR 2017

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:15.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri:

Adnan Klinaku, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Fakete Dushi, Gentiana Rama, Habib Mustafa, Hysni Gërguri, Habibe Gërzhaliu, Isa Hajrizi, Ilmi Azemi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idriizi, Safet Osmani, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakiç.

Mungoi: Syzana Syla

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, Nënkryetari i komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit – në fillim të diskutimit të saj paraqiti një rezymë lidhur me aktivitetin e saj politik në kuvendin e komunës gjatë dhjetë viteve të fundit, më poshtë e gjeni të plotë përmbledhjen e diskutimit të saj: Sot në seancën e fundit të këtij mandati dola këtu për herë të parë ta shfrytëzoj foltoren për një informim personal ndaj publikut, mediave dhe të gjithë atyre që kanë shpreh interesim për kandidaturën time për një mandat të katërt. Dhe unë dëshiroj t'iu njoftoj se unë nuk jam konkurrenca në zgjedhjet e 22 tetorit për të vetmen arsye, duke marrë parasysh që unë në këtë kuvend jam që nga viti 2007, tash bëhen 10 vite dhe arsyeja kryesore është reflektimi im, ndoshta ka ardhur koha që disa që kemi qenë për një kohë kaq të gjatë në këto ulëse të lirojmë vendin për të tjerët. Dhe ndoshta nuk e kisha as moshën dhe as kontributin që kam dhënë ta bëja këtë, por marrë parasysh faktin që disa të tjerë që kanë arsye shumë më të mëdha të reflektojnë, ata nuk e bënë këtë gjest, ndoshta kjo për shkak të egoizmit. Në këtë rast unë dëshiroj t'i falënderoj të gjitha partitë politike që më ofruan mundësinë të jem në listat e tyre, qoftë në zgjedhjet nacionale, por edhe në këto zgjedhje, madje që t'ju prijë në listat e tyre. Kjo nuk do të thotë që unë nuk do të jem një njeri i angazhuar, për më tepër nëse situata politike ndryshon ndoshta në mandatin e ardhshëm do të jem prapë konkurrenca gjithmonë nëse e shoh nevojën se po i duhem kuvendit. Gjithashtu, dëshiroj t'ju uroj të gjithë kandidatëve nëpër listat e ndryshme shumë suksese, duke shpresuar dhe besuar që nuk kanë hyrë në ato lista për një pagë e cila është minimale, por për të kontribuar dhe adresuar problemet e qytetarëve në adresat e duhura, ashtu siç kemi bërë në vitin 2007-2008 kur paga jonë ishte tmerrësisht e ulët. Por, ne kishim vullnetin dhe dëshirën që qytetarët tanë të kenë besim tek ne për hallet dhe problemet e tyre dhe kjo ishte e vetmja arsye pse ne qëndronim në këtë kuvend. Për vitet sa

isha në këtë kuvend, gjithmonë isha në opozitë dhe normalisht që opozita e ka një lloj detyre të kritikës më të theksuar se pozita dhe në këtë rast dëshiroj ta falënderoj kryetarin e komunës për mirëkuptimin e tij ndaj kritikave tona me vend dhe rrallëherë të paqëlluara. Mirëpo të gjitha kanë qenë kritika dashamirëse në mënyrë që përmes kritikave tona, vërejtjeve apo edhe sugjerimeve, jemi munduar që punët dhe aktivitetet të kryhen në mënyrën më të mirë të mundshme, ngase janë kryer për të mirën e qytetarëve tanë dhe vetë neve që jemi pjesë e këtij komuniteti dhe këtij lokaliteti. Kolegë të mi, iu falënderoj për bashkëpunimin e juaj dhe të disave në veçanti që shpeshherë shkelet mbi dinjitetin e juaj, mbi qëndrimet politike vetëm për të mirën e qytetarëve. Meqenëse në këtë kuvend po behën afër 4 vite që aktivitetin tim po e zhvilloj si e pavarur politikisht dhe meqë jemi afër zgjedhjeve, normal që karriera ime nuk më lejon që të qëndroj 100% indiferente ndaj kësaj kauze dhe si e pavarur më jepet e drejta e plotë që në mënyrën më demokratike ta mbështes qoftë një kandidat për kryetar komune apo një listë për anëtarë të kuvendit komunal. Dhe unë këtë herë do ta mbështesë një njeri të cilin e kishim edhe koleg në këtë kuvend dhe udhëheqës të këtij kuvendi, kjo për të vetmen arsye sepse ne i njohim mirë reagimet dhe veprimet e tij në raste të caktuara, duke anashkaluar edhe qëndrimet jo të drejta të partisë së tij për të mirë të qytetarëve dhe shpeshherë duke respektuar më shumë propozimet e opozitës sepse dinte ku është drejtësia. Kështu që i bëj thirrje të gjithë qytetarëve që këtë herë të mos bazohen shumë në partitë politike, por thjeshtë në individ, ashtu siç po veprojnë unë dhe shumë miq të mi, sepse në një situatë tjetër dhe me një kandidaturë tjetër ndoshta edhe qëndrimi im do të ishte ndryshe. Mbështetja e këtij kandidati nuk do të thotë mbështetje edhe për listën e asaj partie për kuvendin komunal, mendoj se kjo është demokracia dhe e drejta e plotë e jona që nuk jemi të përcaktuar nëpër parti politike. Edhe njëherë suksese të gjithë kandidatëve për kryetar të komunës sonë dhe të gjithë kandidatëve për kuvendin komunal. Në fund tha se shpresoj që sadopak ka dhënë për këtë kuvend për këta qytetarë, të cilët e përkrahën dhe më mbështetën për 10 vite. Do të jetë mirënjohëse gjithmonë.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit – duke iu referuar diskutimit të parafolësës së tij, vlerësoi se zonja Ismajli e keqpërdori foltoren e kuvendit, duke mbajtur fjalim politik për mbështetje të një kandidati që garon për potin e kryetarit të komunës. Tutje shtoi se kjo zonjë do të mund të përkrahte secilin kandidat përmes ndonjë konference për media, por assesi nuk ka të drejtë të keqpërdor foltoren e kuvendit për qëllime të fushatës elektorale.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit – kërkoi që në pikën në të ndryshme të futet një pikë shtesë lidhur me emërtimin e një rruge në fshatin Beçuk me emrin e veteranit të UÇK-së Naser Miftari.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – propozoi që pika që ka të bëjë me ndryshimin e rregullores së punës së kuvendit të hiqet nga rendi i ditës.

Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit – pyeti se a është duke u zbatuar rekomandimi i kuvendit për mosaplikimin e kushtëzimit të ofrimit të shërbimeve komunale me vërtetimin e pagesës së taksave për mbeturinat, pasi që qytetarët po ankohen se ky kushtëzim akoma është në fuqi.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit – pyeti se një kërkesë e parashtruar nga shoqata “Drita jonë”, përse nuk është futur në rend të ditës.

Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit – tha se për të mbetet shqetësues fakti se për katër vitet e këtij mandati qeverisës, materialet për pikat e rendit të ditës nuk u sollën sipas afatit ligjor të përcaktuar me ligj dhe me rregulloren e punës së kuvendit. Në fund tha se shpreson se në mandatin e ardhshëm kjo qasje të ndryshojë.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi me 32 vota “për” 2 vota “abstenim” aprovoi këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit e datës 27.07.2017;
2. Shqyrtimi i Draft- buxhetit dhe planeve investuese për vitin 2018;
3. Shqyrtimi i Draft-rregullores të tatimit në pronë për vitin 2018 (shqyrtimi i dytë);
4. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2017;
5. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e vitit shkollor 2016/2017 dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2017/2018;
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e rrugëve për ndërtim me kubëza;
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore;
8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të katit të parë të Muzeut Historik-Etnografik për shkollën e Muzikës “Tefta Tashko”;
9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për kompensimin e kryetarëve të këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës së Vushtrrisë;
10. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e korrje-shirjeve për vitin 2017;
11. Shqyrtimi i Informatës lidhur me punën e KKSB-së për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2017;
12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin e projektit të shkollës në fshatin Beçuk;
13. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ridestinimin e mjeteve nga fondi për transfere dhe subvencione;
14. Shqyrtimi i kërkesës për ofrimin e ndihmës financiare për shërim për Olta Tërrstenën;
15. Shqyrtimi i kërkesës për ofrimin e ndihmës financiare për Muharrem Shabanin;
16. **Të ndryshme.**
 - a). Shqyrtimi i kërkesës për emërtimin e rrugës me emrin e veteranit të UÇK-së Naser Miftari;
 - b). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin zonës me interes publik të pronës së paluajtshme të komunës;
 - c). Shqyrtimi i Draft-rregullores për mënyrën e organizimit dhe funksionimin e bibliotekës “Naim Frashëri”, si dhe nëndegëve të saj në territorin e Vushtrrisë;
 - ç). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rithemelimin e Arkivit komunal të Vushtrrisë;
 - d). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ridestinimin e mjeteve financiare të komunës;
 - dh). Shqyrtimi i Draft-rregullores për organizimin dhe funksionimin e ansambllit komunal të këngëve dhe valleve “Hasan Prishtina” në Vushtri;
 - e). Shqyrtimi i Draft-rregullores për organizimin dhe funksionimin e teatrit të qytetit të Vushtrrisë;
 - ë). Shqyrtimi i Draft-rregullores për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Muzeut Historik-Etnografik në Komunën e Vushtrrisë;
 - f). Shqyrtimi i Draft-rregullores për organizimin dhe funksionimin e Arkivit komunal të Vushtrrisë.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit e datës 27.07.2017

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit e datës 27.07.2017.

2. Shqyrtimi i draft- buxhetit dhe planeve investuese për vitin 2018

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së – paraqiti sqarime hyrëse sa i përket draft-buxhetit të komunës për vitin 2018.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – propozoi që tek rrugët që parashihet të ndërtohen me kubëza, këto projekte të mos ndahen në vite, por të jenë projekt trevjeçar, si dhe në kuadër të buxhetit komunal të futet edhe një rrugë në fshatin Karaçë, pasi kjo është rekomanduar edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa. Gjithashtu propozoi që në kuadër të rrugëve me kubëza të futet edhe rruga “Kalabria” në fshatin Shtitaricë, si dhe rruga “Hysen dhe Xhavit Hyseni, kurse në kolonën 26 të përmirësohet një gabim teknik në vend të emërimit Zeqiri të bëhet Xhavit Bahtiri. Tutje shtoi se buxheti i komunës për vitin 2018 është planifikuar në mënyrën më të mirë të mundshme nga ana e qeverisë komunale, duke u marrë për bazë kërkesat e qytetarëve. Pastaj ceku se në kuadër të këtij buxheti është inkorporuar një projekt, i cili konsiderohet madhor për interesat e qytetarëve. Fjala është për rrugën Vushtrri-Nadakoc-Pestovë, rrugë e cila do ta shkarkojë rrugën magjistrale në segmentin e cekur. Mandej projekt po kaq me vlerë është ndërtimi i objektit për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të UÇK-së, por edhe për skamnorët, projekt ky i cili do të përfundojë brenda afatit trevjeçar. Rregullimi i lumit “Tërrstena” gjithashtu është projekt i inkorporuar në buxhetin komunal për vitin 2018, rregullimi i shtratit të lumit “Podrança”, rregullimi i shtratit të lumit “Silnica”, ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza, mandej ndërtimi i shkollave në fshatin Dumnicë e Mesme, Beçuk dhe Stanoc, nga mallra dhe shërbime është marrë vendimi për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e Vushtrrisë, shërbimi i transportit të nxënësve është planifikuar në buxhet dhe kjo do të fillojë të zbatohet nga 1 janari i vitit 2018 dhe në fund në këtë projektbuxhet janë planifikuar mjete për zgjerimin e rrjetit të ujitjes në fshatin Pantinë dhe Samadrexhë.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit – tha se edhe përkundër faktit se në këtë draft-buxhet janë futur mjaft projekte të rëndësishme së veçantë, propozimet e dhëna nga grupi kuvendar i LDK-së, nuk janë marrë për bazë që të futen në këtë projekt-buxhet. Pastaj vlerësoi se ky projekt-buxhet nuk është zhvillimor, për faktin se nuk i është dhënë prioritet bujqësisë edhe pse ka rritje të subvencioneve në këtë degë të ekonomisë. Në lidhje me draft-buxhetin komunal për vitin 2018, në emër të grupit kuvendar të LDK-së paraqiti këto projekte: subvencionimi i ujitjes për bujqit, subvencionimi i analizave të tokës bujqësore dhe lloji i rendimenteve, ndarja e buxhetit për teren sportiv multifunksional në qytet, mandej rritja e të hyrave vetanake me zgjerim të bazës tatimore, por jo me rritje të tatimit.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – tha se janë planifikuar mjete në buxhetin e vitit 2018 për terrene sportive, multifunksionale tek stadiumi “Musa Abazi”, mjetet janë paraparë edhe për ndërtimin e një ure në fshatin Dobërllukë, kurse analizat e tokës janë në kompetencë të Ministrisë së Bujqësisë.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit – pyeti se sa është shuma e mjeteve të planifikuara për rinovimin e objekteve shëndetësore. Në këtë kontekst propozoi që shuma prej 15.000 € të hiqet dhe të dedikohet për blerjen e aparaturës shëndetësore (pajisje shëndetësore), për faktin se ka nevojë të pajisen me një rëntgen për fotografimin e dhëmbëve.

Abit Abiti ZKF – paraqiti sqarime profesionale lidhur me draft-buxhetin e komunës për vitin 2018, duke dhënë përgjigje në çështjet e ngritura nga anëtarët e kuvendit.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit – tha se sa i përket shërbimeve të transportit të nxënësve, ato të mbulimit të shpenzimeve të varrimit, si dhe ndërtimi i çerdhes, këto projekte janë propozuar për katër vite me radhë nga grupi kuvendar i LVV-së, dhe tani i vjen shumë mirë që në fund të mandatit janë planifikuar mjete financiare për realizmin e këtyre projekteve. Tutje vlerësoi se buxheti i planifikuar për vitin 2018, nuk ndryshon nga ato të viteve të kaluara, sepse është “buxhet i asfaltit dhe i betonit”, buxhet klientelist me idenë që “unë ta shtroj rrugën, ndërsa ti më jep votën” dhe unë të jap tenderin, kurse ju më jepni 10% të mjeteve të atij tenderi.

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit – tha se është mirë që po ndërtohet rruga në fshatin Gumnishtë, me qëllim që të parandalohet migrimi i banorëve nga ky fshat, dhe në këtë kontekst propozoi që mjetet e planifikuara për këtë projekt në vitin 2019 të planifikohen në vitin 2018 me qëllim që ky projekt të përfundojë sa më parë që të jetë e mundur.

Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit – e përkrahi propozimin e parafolësës së saj dhe kërkoi që kompania e cila është duke shfrytëzuar zhavorrin në fshatin Gumnishtë, të ndërmarrë veprime për rregullimin e asaj rruge.

Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit – tha se vërejtjet të cilat i ka dhënë në KPF nuk janë marrë për bazë, dhe përsëriti se duhet të bëhet qartësi i projekteve si për lokalitet ashtu edhe për afatin e përfundimit të projektit dhe jo që ato të paraqiten në mënyrë të përgjithësuar.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 23 vota “për”, 8 vota “kundër” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprohet buxheti i Komunës së Vushtrrisë, KAB-i dhe lista e projekteve kapitale për vitet 2018-2020, konform Qarkoreve Buxhetore 01/2018 dhe 02/2018 të lëshuara nga MF-ja.

2. Shuma e përgjithshme e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2018 është 17,203,662.00 €, prej të cilave për:

- Paga dhe mëditje.....9,709,493.00 €.
- Mallra dhe shërbime.....2,551,008.00 €.
- Shpenzime komunale.....241,042.00 €.
- Subvencione.....182,914.00 €.
- Shpenzime kapitale.....4,519,205.00 €.

Gjithsej:.....17,203,662.00 €.

3. Të hyrat vetanake të planifikuara.....2,275,368.00 €.

4. Mjetet financiare të cekura në pikën 2 dhe 3 të këtij vendimi janë në pajtim me Qarkoren Buxhetore 2018/02 të MF-së, në bazë të kufijve buxhetor.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Kryetari i komunës dhe drejtoritë tjera kompetente.

6. Tabela 4.1- Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2018; tabela 4.2 – Investimet kapitale në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2018-2020; dhe tabela 4.3, janë pjesë e këtij vendimi, të bashkëngjitura në shtojcë.

7. Ky vendim hyn në fuqi pas aprovimit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit dhe i njëjti i dorëzohet Ministrisë së Financave për zbatim.

3. Shqyrtimi i parë i Draft-Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2018

Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit – propozoi që zona e parë tatimore të ndahet në dy nënzona, kjo për arsye se vlera e pronës nuk është e njëjtë, mandej të bëhet ndarja e pronës në etazhe me qëllim që të kemi vlerësim dhe aplikim real të tarifave tatimore.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 21 vota “për”, 6 vota “kundër”, të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprohet Rregullorja mbi Tatimin në Pronën e Paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2018.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas aprovimit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – paraqiti sqarime lidhur me disa çështje që lidhen me diskutimin e anëtares së kuvendit Arta Ismajli dhe u përgjigj në çështjet e ngritura nga grupi kuvendar i LDK-së.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit – përsëriti se anëtarja e kuvendit znj. Ismajli e keqpërdori foltoren e kuvendit duke bërë fushatë politike, duke mbështet një kandidat për kryetar komune, dhe aq më keq kjo u lejua nga kryesuesi i kuvendit dhe u mbështet me duartrokitje.

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit – tha se e shfrytëzoi foltoren e kuvendit për t'i informuar qytetarët lidhur me moskandidimin e saj, dhe ceku se nëse diskutimi i saj paraqet shkelje ligjore, atëherë ajo është e gatshme të përgjigjet dhe t'i bartë pasojat.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit - duke iu referuar diskutimit të znj. Ismajli ceku se nëse ajo ka diçka personale, atëherë ajo mund ta thotë lirisht dhe përsëriti se ajo e shpërdoroi foltoren e kuvendit për fushatë parazgjedhore.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit – tha se duhet të lihen mënjane debatet e thata dhe se do të koncentrohemi në temat që janë objekt i rendit të ditës, të cilat janë me interes për qytetarët e komunës tonë.

4. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese për gjashtëmujorin e parë të vitit 2017

5. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e vitit shkollor 2016/2017 dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2017/2018

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit – duke iu referuar informatës në fjalë, ceku se një konkurs i përgatitur në bashkëpunim me OJQ-në “Smart” për angazhimin në punë të shumë mësimdhënësve. Lidhur me këtë çështje ai njoftoi se ka pasur mjaft shumë ankesa nga qytetarët për padrejtësi që janë bërë në punësimin e këtyre mësimdhënësve, andaj ai kërkoi sqarime lidhur me këtë konkurs, duke u njoftuar kuvendi se kush është kjo organizatë, çfarë kompetencash ka, dhe se përse përzgjedhjen e ka bërë kjo kompani e jo komuna. Në fund ai kërkoi një informatë të detajuar lidhur me këtë çështje dhe shtoi se komuna duhet të ndërmarrë veprime për mënjanimin e shumë shkeljeve që kanë ndodhur në këtë konkurs.

Bajram Mulaku, Kryetar i komunës – pasi falënderoi anëtarët e kuvendit për bashkëpunimin që kanë pasur gjatë këtyre katër viteve të mandatit, vlerësoi se gjatë gjithë këtyre viteve sa ka qenë në pozitën e të parit të komunës, ka bërë përpjekje që të jetë kryetar i të gjithë qytetarëve të komunës dhe të ketë një bashkëpunim të shëndoshë me të gjithë e sidomos me anëtarët e kuvendit të komunës. Pastaj ai ceku se çdo propozim i bërë nga anëtarët e kuvendit për të ka qenë i vlefshëm dhe brenda mundësive të tij është munduar që ta zbatojë në praktikë. Lidhur me punën e tij ai ceku se ndihet mirë që shumë projekte janë jetësuar gjatë mandateve të tij dhe krejt këto në interes të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë. Mandej ai shtoi se për punën e tij e ka ndërgjegjen e pastër se ka punuar vetëm për interesat e qytetarëve, andaj në këtë kontekst iu uroi suksese të gjithë kandidatëve qoftë për kryetar të komunës apo për anëtarë të kuvendit. Në vazhdim ai duke iu referuar diskutimit të anëtarit të kuvendit z. Selaci njoftoi se para disa javëve një organizatë e quajtur “Smart” ka ardhur në zyrat e komunës dhe ka shprehur gatishmërinë që të bashkëpunojë me komunë, për angazhimin e disa punëtorëve arsimor në

nivelin parashkollor, ku nga komuna është kërkuar që të sigurohet hapësira shkollore, kurse financimi i këtyre mësimdhënësve do të bëhet nga kjo organizatë dhe për këtë është nënshkruar marrëveshja.

Agim Miftari, drejtor i Drejtorisë së Arsimit – paraqiti sqarime lidhur me informatën në fjalë duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit – tha se gjatë pranimit të këtyre punëtorëve ka pasur shkelje të procedurave dhe kushteve të konkursit, ku në një rast është punësuar gruaja e një zyrtari të lartë të komunës, por shkelje ka pasur edhe për sa i përket kualifikimit të këtyre punëtorëve.

Bajram Mulaku, Kryetar i komunës – tha se lidhur me angazhimin e këtyre punëtorëve do të kërkojë raport dhe në mënyrë periodike këta mësimdhënës do të kontrollohen, ku ceku se shpreson se ky projekt do të realizohet me sukses.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit – tha se ky projekt është madhor, kur dihet se po punësohen një numër i konsiderueshëm i psikologëve dhe pedagogëve dhe kjo sigurisht se ka efekt mjaft pozitiv për komunën tonë. Tutje shtoi se personat që janë angazhuar në punë në saje të këtij projekti kanë kryer trajnime në SHMU-2 dhe se këta kandidatë janë të përgatitur profesionalisht. Ajo çka është e rëndësishme, është që ky projekt të mbikëqyret dhe të zbatohet me përpikëri.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit – tha se realizimi i këtij projekti meriton të përgëzohet, për shkak se ky projekt po mundëson punësimin e disa psikologëve dhe pedagogëve dhe kjo është gjë me interes për komunën tonë. Pastaj ai vlerësoi se është aftësi e menaxherit të projektit që ka mund të thith mjetet për këtë projekt dhe ka bërë diçka të mirë për komunën tonë.

6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e rrugëve për ndërtim me kubëza

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – tha se ndërtimi i këtyre rrugëve po bëhet nga mjetet që kanë tepruar nga projektet tjera kapitale, dhe ceku se është mirë që të bëhet ridestini i këtyre mjeteve për faktin që këto mjete të mos shkojnë në suficit, kurse për këto rrugë është bërë edhe paramasa. Pastaj propozoi që rruga në fshatin Brusnik afër shamisë të shtohet edhe për 70 metra, ashtu që të bëhet kompletimi dhe qasja më mirë në këtë rrugë.

Bajram Mulaku, Kryetar i komunës – njoftoi se për këto rrugë është hartuar paramasa dhe shtoi se nëse nga këto projekte tepronë mjete financiare, atëherë le të jepet propozimi që rruga në fshatin Karaçë në gjatësi prej 300 m të ndërtohet nga këto mjete, të cilat do të tepronin me qëllim që mos të ketë nevojë të merret edhe një vendim tjetër i kuvendit.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 26 vota “për”, të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim caktohen rrugët për ndërtim me kubëza nga mjetet e mbetura prej projektit të njëjtë (rrugëve me kubëza), kodi i projektit 41406.

2. Ndërtimi i rrugëve me kubëza bëhet në lokalitete si në vijim:

2.1 Rruga „Jeton Tërrstena” L=131 m, b=4 m;

2.2 Rruga „Rafet e Burim Behrami” L=110 m, b=4 m;

2.3 Segmenti i rr. „Nezir Imeri” L=63 m, b=3.5 m;

2.4 Rruga „Veli dhe Kurtesh Haxhiu” L=280 m, b=3.5 m;

2.5 “Lagjja e Mërrnicëve” L=200 m, b=3 m;

2.6 Rruga „Ismail Parduzi” L=200 m, b=3 m;

2.7 Rruga „Dituria” L=277 m, b=3.5 m;

2.8 Rruga në fshatin Brusnik te xhamia L=215 m, b=3.5 m;

2.9 Rruga në Brusnik rr. „Bec Muzaqi” segmenti I dhe II L=230 m, b=3.5 m;

2.10 Segmenti i rr. „Lumni Surdulli” L=55 m, b=3.5 m;

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shërbime Publike.

7.Shqyrtimi i Propozim-vendimit për lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Lejohet ndërrimi i destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore në parcelën kadastrale: nr.P-70202030-00575-0, me kulturë arë e klasës së 5 (pestë), në sipërfaqe prej 1750m² të marrë nga sipërfaqja totale 12778m², Zona Kadastrale Druar, pronë e Haxhere Murtezit me vendbanim në fshatin Druar, Komuna Vushtrri.

2. Qëllimi i lejjimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në parcelën kadastrale, të cekur si në pikën 1 të këtij vendimi, është ndërtimi i objektit fermë për kultivimin e zogjve.

3. Lejen ndërtimore dhe kushtet për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit nga pika 2 e këtij vendimi, do ta lëshojë dhe përcaktojë konform dispozitave ligjore Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit pas pagesës së tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore.

4. Obligohet pronari i parcelës nga pika 1 e këtij vendimi që të bëjë pagesën e tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore sipas nenit 14.2 nën ”b” të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore Nr.41/2006, përmes Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

8.Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të katit të parë të Muzeut Historik-Etnografik për shkollën e Muzikës “Tefta Tashko”

Shukrane Begu, udhëheqëse e Muzeut - sqaroi se bëhet fjalë për dhënien në shfrytëzim të pjesës lindore të katit të parë të Muzeut Historik-Etnografik, në hapësirë prej pesë kthinave dhe një nyje sanitare e cila do të shfrytëzohet edhe nga personeli i muzeut.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim Shkollës së Muzikës “Tefta Tashko” paralele e ndarë në Vushtrri, i jepet në shfrytëzim të përkohshëm, pjesa lindore e katit të parë e Muzeut Historik-Etnografik (Shtëpia e Mahmut agë Gjinollit) prej gjashtë (6) kthinave, ku njëra prej tyre do të shfrytëzohet për një sanitare nga stafi i muzeut dhe i shkollës së muzikës.

2. Qëllimi i nxjerrjes së këtij vendimi, është dhënia afatshkurtër e pronës së komunës në shfrytëzim prej datës 01.01.2018 deri më 31.12.2019.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për kompensimin e kryetarëve të këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës së Vushtrrisë

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – propozoi që të mbahen gjashtë takime (mbledhje) të këshillave të fshatrave për një vit kalendarik dhe kompensimi i kryetarëve të jetë 50 € për muaj.

Bajram Mulaku, Kryetar i komunës – tha se logjika e ndarjes së mëditjes me nga 25 € për mbledhjen kur mbahet dhe mëditja tjetër me nga 25 € në momentin kur kryetarët e këshillave raportojnë para organeve komunale ka për qëllim që këta të jenë më aktiv dhe më përgjegjës për punën dhe aktivitetin e tyre.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovohet kompensimi në shumën prej njëzet e pesë (25.00) euro për çdo mbledhje të mbajtur nga kryetarët e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës së Vushtrrisë.

2. Mëditjet si në pikën 1 të këtij vendimi do të kompensohen, gjashtë (6) mëditje për mbledhjet, si dhe 6 mëditje në momentin ku kryetarët e fshatrave raportojnë para organeve komunale.

3. Numri i mbledhjeve me kompensim është gjashtë (6), ndërsa pa kompensim mund të mbahen edhe më shumë.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Administratë dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

10. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e korrje-shirjeve për vitin 2017

11. Shqyrtimi i Informatës lidhur me punën e KKSB-së për gjashtëmujorin e parë të vitit 2017

12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin e projektit të shkollës në fshatin Beçuk

Bajram Mulaku, Kryetar i komunës – sqaroi se shkolla në fshatin Beçuk ishte planifikuar që të rinovohet, por pasi kishte filluar meremetimi i saj është parë që ai objekt është i paqëndrueshëm dhe nga ky shkak është vendosur që ky projekt të ndryshohet, andaj për këtë nevojitet vendimi i kuvendit që të ndërtohet nga themelet shkolla në fshatin Beçuk.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

13. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ridestininimin e mjeteve nga fondi për transfere dhe subvencione

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

- 1. Me këtë vendim shuma prej një mijë e shtatëqind euro (1,700.00) € ridestinohet nga kategoria subvencione (pozicioni KVRL), në realizimin e projektit “Ngjyrosja e hapësirave publike, të cilat dedikohen për organizatën joqeveritare e cila do të dalë fituese në konkursin për “Ngjyrosjen e hapësirave publike”.**
- 2. Mjetet e cekura në pikën 1 të këtij vendimi, ndahen në bazë të kritereve dhe kushteve të përcaktuara me Rregulloren 01Nr.37-2/11 për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione për Ndhimë Momentale Entiteteve Publike dhe Jopublike.**
- 3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorja për Buxhet dhe Financa.**

14. Shqyrtimi i kërkesës për ofrimin e ndihmës financiare për shërim për Olta Tërrstenën

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – paraqiti sqarime lidhur me këtë kërkesë, duke arsyetuar atë ku ceku se fjala është për ofrimin e ndihmës financiare për shërim, gjegjësisht (për një operacion në zemër), për Olta Tërrstenën, në ç’rast shpenzimet e këtij operacioni i mbulon një organizatë joqeveritare ndërkombëtare, por komuna duhet t’i sigurojë shpenzimet e udhëtimit për nënën e fëmijës në vlerë prej 3000 €, andaj nga kjo kërkoi që kjo kërkesë të aprovohet, ku mjetet financiare do të mund të siguroheshin nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.

Bajram Mulaku, Kryetar i komunës – tha se këto kërkesa janë mjaft të ndjeshme, si për qeverinë ashtu edhe për kuvendin e komunës. Pastaj sqaroi se subvencionet për këtë vit janë shpenzuar shumë më herët sesa përfundimi i vitit kalendarik, dhe për këtë ka kërkuar nga Drejtorja e Financave që të ofrojë një listë për gjendjen e subvencioneve për vitin 2017. Mandej ai njoftoi kuvendin se përpos në zyrën e kryetarit që ka mbetur një shumë simbolike e subvencioneve, të cilat janë të dedikuara për raste emergjente, subvencione në tjerat dikastere për vitin 2017 nuk kanë mbetur. Andaj sa i përket subvencioneve ceku se mjete nuk ka, kurse nga mallrat dhe shërbime mund të merren paratë, por për këtë duhet të shikohet ana ligjore, se a kemi apo nuk kemi të drejtë që të bëhet pagesa.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

- 1. Me këtë vendim lejohen mjete financiare në vlerë prej tre mijë euro (3.000 €) nga buxheti i komunës – kategoria e mallrave dhe shërbimeve ose nga kategoria e subvencioneve, për Olta/Agron/Tërrstenën me banim në Vushtrri, Komuna e Vushtrrisë.**
- 2. Shuma e cekur në pikën 1 të këtij vendimi, ndahet në emër të Agron Tërrstenës, (babai i Olta Tërrstenës) dhe do të shërbejë për shërimin e sëmundjes së saj.**
- 3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtorja për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Drejtorja për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit.**

15. Shqyrtimi i kërkesës për ofrimin e ndihmës financiare për Muharrem Shabanin

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim lejohen mjete financiare në vlerë prej një mijë e pesëqind euro (1.500 €) nga buxheti i komunës – kategoria e mallrave dhe shërbimeve ose nga kategoria e subvencioneve, për Muharrem Shabanin me banim në Vushtrri, Komuna e Vushtrrisë.
2. Shuma e cekur në pikën 1 të këtij vendimi, ndahet me qëllim të mbulimit të shpenzimeve të operimit të tij.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit.

16.Të ndryshme.

- a). Shqyrtimi i kërkesës për emërtimin e rrugës me emrin e veteranit të UÇK-së Naser Miftari

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovet emërtimi i rrugës së re me emrin e veteranit të UÇK-së Naser Miftari në fshatin Beçuk, Komuna e Vushtrrisë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

- b). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin zonës me interes publik të pronës së paluajtshme të komunës

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – bëri të ditur se kjo zonë për të cilën po diskutohet, ka të bëjë me një parcelë në fshatin Stanoc i Epërm tek varrezat e dëshmorëve. Kjo konsiderohet që të dedikohet si lokacion për varrezat e Veteranëve të UÇK-së dhe që brenda këtij vendimi të inkorporohet kërkesa e Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve, që një pjesë e kësaj prone të ndahet për lokacion të varrezave të prindërve të dëshmorëve.

Gëzim Zuqaku, kryetar i SHFD-së - paraqiti sqarime para anëtarëve të kuvendit, duke arsyetuar kërkesën e Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve si dhe arsyetoi se përse është e nevojshme që të merret një vendim i tillë.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit – tha se lidhur me këtë çështje do të ishte më mirë që në këtë mbledhje të mos merret kurrfarë vendimi, për faktin se në disa raste tjera ishin marrë vendime për këso lloj çështjesh, por më vonë është dashur që ato vendime të anulohen. Pastaj ai vlerësoi se kjo çështje është mjaft e ndjeshme, për faktin se Dëshmorët e Kombit “nuk janë të familjeve”, por janë të të gjithëve, andaj lidhur me caktimin e këtij lokacioni duhet të bëhen analiza të mirëfillta dhe konform kësaj të merret një vendim i arsyeshëm dhe i drejtë.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se në këtë mbledhje duhet të merret vendimi lidhur me këtë çështje, pasi në këtë rast kemi të bëjmë me caktimin e një lokacioni për varrezat e prindërve të dëshmorëve dhe kjo po bëhet afër varrezave të dëshmorëve dhe sigurisht se kjo është një gjë pozitive. Mandej ai ceku se kjo çështje ka kaluar në filtrat e shoqatës kompetente dhe se kjo si e tillë duhet të marrë një kaheje apo një epilog, duke u aprovuar vendimi për këtë kërkesë.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit – tha se ekziston një frikë, që nëse këta prindër favorizohen, atëherë mos po irritohen shumë familje tjera që kanë dhënë dëshmorë në kohëra të ndryshme të historisë sonë, andaj për këtë kërkoi që të ketë studim të kësaj çështjeje dhe ujdi në aprovimin e saj. Në fund tha se të gjithë të rënëve për lirinë e Kosovës, duhet t’u jepet vendi i merituar, të cilët janë të shumë dhe që kanë punuar e vepruar në kohëra të ndryshme. Andaj për çështjen në fjalë tha se duhet të bëhen analizat e mirëfillta para se të merret një vendim i tillë.

Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit – tha se kjo çështje duhet të shtyhet për mandatin e ardhshëm të kuvendit, pasi tani jemi në mbledhjen e fundit, pasi që vlerësoi se kjo temë nuk është studiuar në mënyrën më të mirë të mundshme.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit – tha se qëllimi i Shoqatës të familjeve të dëshmorëve është i mirë, por nuk është në kohën e duhur. Tutje shtoi se për shoqatat, por edhe për kuvendin më e rëndësishme kishte me qenë që të merret një vendim që parcela nga varrezat e dëshmorëve e deri tek rruga kryesore, të shndërrohet në pronë komunale dhe mos të lejohet ndonjë ndërtim në atë vend pasi që kështu i humbet vlera ati lokaliteti dhe do shkaktonte irritimin e familjeve të dëshmorëve. Për këtë çështje ai kërkoi që kuvendi ta themelojë një komision ku do të përfshihej edhe kryesia e SHFD-së, mandej të bëhet edhe një diskutim publik dhe tek pastaj të merret vendimi për këtë çështje.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit – tha se në afërsi të varrezave të dëshmorëve, do të duhej të ndërtohej një pushimore (park), ku familjarët, por edhe vizitorët tjerë do të ulëshin për të pushuar si dhe të ndërtohet një çezmë.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – kërkoi pesë minuta pauzë që grupet kuvendare së bashku me kryetarin e komunës dhe përfaqësuesin e shoqatës të gjejnë një konsensus lidhur me çështjen në fjalë.

Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit – propozoi që të caktohet lokacioni njëherë për varrezat e veteranëve të UÇK-së, e mandej të gjenden edhe prona tjera për caktimin e lokacionit për varreza për kategoritë tjera të luftës.

Bajram Mulaku, Kryetar i komunës – tha se gjendemi në një moment delikat, pasi nuk kemi një rregullore për caktimin dhe kategorizimin e të merituarve që kanë kontribuar për Shtetin e Kosovës. Andaj në këtë kontekst shtoi se një lokalitet për caktimin e varrezave për këto kategori duhet të gjendet, kurse prona e cila është apostrofuar që të caktohet për këtë destinim, duhet të shpallet zonë me interes të përgjithshëm, si dhe të iniciohen procedurat që kjo pronë të kthehet në pronësi komunale. Në fund ai sugjeroi që ky vendim të merret më vonë ndoshta në mandatin e ardhshëm të kuvendit, ku do të aprovohej edhe një rregullore për këtë qëllim.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – propozoi që për këtë çështje të merret vendimi me të cilin do të vendosej për tri çështje dhe atë që me këtë vendim kjo pronë të shpallet zonë e interesit për komunën, një pjesë e kësaj prone të destinohet për varrezat e veteranëve të UÇK-së, kurse pjesa tjetër të destinohet si lokacion për varrezat e të merituarve.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit – tha se është i mendimit që në këtë pronë kuvendi të marrë vendim për shpallje të zonës së interesit, dhe që të kihet kujdes që në këtë lokalitet të mos lejohet ndërtimi pasi aty gjenden varrezat e dëshmorëve.

Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit – tha se do të ishte mirë që në këtë mbledhje të merrej vendimi që në parcelën ku gjenden varrezat e dëshmorëve, më poshtë rrethojës së këtyre varrezave të caktohet lokacioni për varreza të veteranëve të UÇK-së.

Idriz Muzaqi, Udhëheqës i Zyrës Ligjore - tha se problemi themelor i kësaj çështjeje është ai i pronësisë, pasi që kjo sipërfaqe afërsisht prej 5 hektarë është në pronësi të Kooperativës bujqësore e që menaxhohet nga AKP-ja. Andaj ai ceku se tani në këto rrethana nuk mund të merret ndonjë vendim, por duhet t'i rekomandohet organeve të ardhshme që ta bëjnë zgjidhjen e çështjes se pronësisë të kësaj prone në të ardhmen.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – propozoi që të merret një vendim për caktimin e zonës me interes në këtë pronë dhe shtoi se derisa të zgjidhet statusi i pronësisë së kësaj prone të mos merret ndonjë vendim tjetër.

Në fund të diskutimeve lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” i rekomandoi qeverisë së ardhshme që të angazhohet në zgjidhjen e statusit të pronës për pronat ku gjenden varrezat e dëshmorëve, të cilat janë në pronësi të kooperativës bujqësore e që menaxhohen nga AKP-ja.

c). Shqyrtimi i Draft-Rregullores për Mënyrën e Organizimit dhe Funkzionimin e bibliotekës “Naim Frashëri”, si dhe nëndegëve të saj në territorin e Vushtrrisë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” aprovoi Rregulloren për Mënyrën e Organizimit dhe Funkzionimin e bibliotekës “Naim Frashëri”, si dhe nëndegëve të saj në territorin e Vushtrrisë.

ç). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rithemelimin e arkivit komunal të Vushtrrisë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim rithemelohet Arkivi Komunal i Vushtrrisë.
2. Lokacioni i Arkivit Komunal gjendet në objektin e ish-TMK-së, në rrugën “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” në Vushtrri, i cili do të transferohet në objektin e Qendrës së Kulturës “Hasan Prishtina” pas përfundimit të punimeve.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi Nr.022-34 i datës 10.07.1980.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe udhëheqësi i arkivit komunal.

d). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ridestinimin e mjeteve financiare të komunës

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim, bëhet ridestini i mjeteve të investimeve kapitale të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, në shumë të përgjithshme prej 6122 € si në vijim:

1.1 Projekti ”Meremetimi i QMF-së në Lumadh” i vitit 2017 (programi 74450, kodi i projektit 45242) pas përfundimit të tij ka rezultuar në mbetjen e mjeteve në shumë prej 5280 euro.

1.2 Projekti “Pajisje mjekësore” i vitit 2017 (programi 74450, kodi i projektit 45253) pas realizimit të këtij projekti kanë mbetur 327 euro.

1.3 Projekti “Furnizim me inventar” i vitit 2017 (programi 74450, kodi i projektit 45261) pas realizimit të këtij projekti kanë mbetur 515 euro.

2. Shuma e mjeteve të cekura si në pikën 1 të këtij vendimi, ridestinohen në projektin e ri për vitin 2017 Pajisje (akses-kontroll për hyrje-dalje të punëtorëve të shëndetësisë).

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale.

dh). Shqyrtimi i Draft-Rregullores për Organizimin dhe Funkzionimin e Ansambllit Komunal të Këngëve dhe Valleve “Hasan Prishtina” në Vushtrri

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” aprovoi Rregulloren për Organizimin dhe Funkzionimin e Ansambllit Komunal të Këngëve dhe Valleve “Hasan Prishtina” në Vushtrri.

e). Shqyrtimi i Draft-Rregullores për Organizimin dhe Funkcionimin e Teatrit të Qytetit të Vushtrrisë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” aprovoi Rregulloren për Organizimin dhe Funkcionimin e Teatrit të Qytetit të Vushtrrisë.

ë). Shqyrtimi i Draft-Rregullores për Mënyrën e Organizimit dhe Funkcionimit të Muzeut Historik-Etnografik në Komunën e Vushtrrisë

Shukrane Begu, udhëheqëse e Muzeut - kërkoi që të bëhet ndryshimi tek neni 9 i kësaj rregulloreje, ku thuhet udhëheqësi i muzeut, të jetë drejtori i muzeut.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” aprovoi Rregulloren për Mënyrën e Organizimit dhe Funkcionimit të Muzeut Historik-Etnografik në Komunën e Vushtrrisë.

f). Shqyrtimi i Draft-Rregullores për Organizimin dhe Funkcionimin e Arkivit Komunal të Vushtrrisë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” aprovoi Rregulloren për Organizimin dhe Funkcionimin e Arkivit Komunal të Vushtrrisë.

g). Pyetjet e anëtarëve të kuvendit:

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit – kërkoi që të bëhet shtrimi i rrugës alternative tek ura e fshatit Gllavatin.

Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit – pyeti se çka po ndodh me kanalizimin në fshatin Dalak dhe Shtitaricë, pasi që banorët e këtyre fshatrave kanë bërë një ankesë për dëmtim të rrjetit të kanalizimit, andaj pyeti sa a ka ndërmarrë komuna ndonjë veprim për sanimin e këtij problemi.

Bajram Mulaku, Kryetar i komunës – tha se vendimi i kuvendit për heqjen e kushtëzimit të qytetarëve për pagesën e taksës për mbeturina, për ofrimin e shërbimeve komunale do të zbatohet dhe këtë e ka kërkuar nga Drejtoria e Financave. Mandej lidhur me dërgimin e materialit të kuvendit në afat ligjor, ceku se është e vështirë që ky afat të respektohet në përpikëri pasi që pas këtij afati paraqiten çështje që janë me rëndësi të futen në rend të ditës. Lidhur me rrugën tek ura e fshatit Gllavatin ceku se ajo shumë shpejt do të rregullohet. Mandej lidhur me kanalizimin në fshatin Dalak dhe Shtitaricë ceku se është i njoftuar me këtë problem dhe shtoi se e gjithë infrastruktura e ujërave të zeza pasi të ndërtohet kalon në pronësi të ndërmarrjes publike dhe tani komuna nuk ka obligim të merret me mirëmbajtjen e kësaj infrastrukture.

Mbledhja përfundoi në orën 14:10.

Bastri Duraku

Shpëtim Zhegrova

Procesmbajtës

Kryesues i Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA INAUGURUESE E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË,
MBAJTUR MË 20 DHJETOR 2017

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:20.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri:
Abdullah Vojvoda, Adnan Lahu, Agron Përçuku, Ali Januzi, Arta Ymeri, Bahrije Ademi Murati, Bajram Mulaku, Berat Asllani, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fatmire Saraçi, Fjolla Ujkani, Gentiana Rama, Gresa Muli, Habibe Gërxhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Lorik Maxhuni, Lutfi Bilalli, Mehdi Bejtullahu, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli-Latifi, Miljan Bojković, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Qerim Selimi, Rrezarta Krasniqi, Sadije Bajgora, Safet Idrizi, Sami Istrefi, Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Teuta Aruçi - Shartari, Ymer Haradinaj.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, komandanti i Stacionit Policor në Vushtri, përfaqësuesi i Akademisë Policore në Vushtri, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile, mysafirë dhe qytetarë.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Bajram Mulaku – anëtar i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Sami Istrefi, anëtar i kuvendit - propozoi që në rend të ditës të futet edhe fjala përshëndetëse e ish-Kryetarit të Komunës Bajram Mulaku.

Pas votimit Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mënyrë “unanime” aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Dhënia e betimit të anëtarëve të kuvendit dhe e kryetarit të komunës (pjesa solemne) dhe
 2. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë (pjesa zgjedhore).
-
1. Dhënia e betimit të anëtarëve të kuvendit dhe e kryetarit të komunës (pjesa solemne)

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - propozoi që anëtar i komisionit për verifikimin e mandateve nga radhët e PDK-së të jetë Qerim Selimi.

Shkëlzen Feka, anëtar i kuvendit - propozoi që anëtar i komisionit për verifikimin e mandateve të anëtarëve të kuvendit nga radhët e LDK-së të jetë Agron Përçuku.

Sadije Bajgora, anëtare e kuvendit - propozoi që anëtar i komisionit për verifikimin e mandateve të anëtarëve të kuvendit nga radhët e LB-së të jetë Nezir Klinaku.

Pas votimit, kuvendi në mënyrë unanime miratoi propozimet për themelimin e komisionit për verifikimin e mandateve të kuvendit në këtë përbërje:

**Qerim Selimi nga radhët e PDK-së;
Agron Përçuku nga radhët e koalicionit LDK, LVV, AKR, AAK dhe Nisma;
Nezir Klinaku nga radhët e LB-së.**

Komisioni i sipërcekur bëri verifikimin e mandateve të kuvendit, duke lexuar emrat e secilit anëtar të zgjedhur të kuvendit.

Në vazhdim të mbledhjes anëtarët e kuvendit dhanë betimin solemn, duke u bërë anëtarë të kuvendit me të drejta të plota.

Gjithashtu betimin solemn para kuvendit e dha edhe kryetari i zgjedhur i Komunës së Vushtrrisë z. Xhafer Tahiri.

Xhafer Tahir, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë - pasi dha betimin solemn si kryetar i komunës, iu drejtua kuvendit me një fjalim përshëndetës, ku së pari falënderoi qytetarët e Komunës së Vushtrrisë për besimin e dhënë që të udhëheqë komunën. Tutje ai u zotua se së bashku me ekipin e tij do të udhëheqë një komunë të hapur, transparente, që i jep llogari qytetarit, një komunë e cila do t'i shërbejë interesave të qytetarit të Vushtrrisë, një komunë e cila do t'i shërbejë të gjithëve më mirë, më drejt më paanshëm. Pastaj ceku se bashkë me ekipin e tij do t'i realizojnë të gjitha premtimet e dhëna nga ana e tij për transformimin e Qytetit të Vushtrrisë. Në vazhdim ai falënderoi partnerët e koalicionit për ndihmën e dhënë në fitoren e tij në balotazhin zgjedhor, të mbajtur më 19 nëntor 2017. Një falënderim të veçantë ai i bëri strukturave të LDK-së dhe gjithë anëtarësisë së saj për ndihmën e sinqertë dhe të pashoq për ndryshimet pozitive dhe cilësore që kanë ndodhur më 19 nëntor. Në fund ai i ftoi të gjithë anëtarët e kuvendit që të punojnë së bashku për interesat e qytetarit të Vushtrrisë dhe që bashkërisht t'i realizojnë projektet që janë me interes të përgjithshëm për qytetarin dhe Komunën e Vushtrrisë.

Bajram Mulaku, ish - Kryetar i Komunës së Vushtrrisë - në fjalimin e tij përshëndetës si ish-kryetar i Komunës së Vushtrrisë, iu drejtua anëtarëve të zgjedhur të kuvendit dhe qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë, me një fjalë rasti, duke shprehur se ishte nder, privilegj e mbi të gjitha përgjegjësi që të jetë në krye të komunës për tri mandate radhazi. Tutje shtoi se me tërë qenien e tij, me gjithë kapacitetin intelektual dhe energjinë është munduar që të bëjë më të mirën e mundshme për interesin e qytetarit të Vushtrrisë. Pastaj vlerësoi se në një rrethanë bile në të gjitha rrethanat tjera gjithmonë ka hapësirë që gjërat të bëhen më mirë, porse në rrafshin real puna që është bërë në këto tri mandate ka rezultuar me ndryshime pozitive në përmirësimin e jetës së qytetarit të Komunës së Vushtrrisë. Në vazhdim ai dha një rezymë të shkurtër lidhur me punët dhe projektet që janë realizuar përgjatë viteve që ai ka qeverisur në Komunën e Vushtrrisë, duke cekur se është aprovuar Plani Zhvillimor i Komunës së Vushtrrisë, mandej është bërë rritja e buxhetit të komunës, ku në saje të kësaj janë realizuar 1855 projekte me vlerë financiare prej 110,833.252 €, nga kjo shumë komuna ka participuar me më shumë se 40 milionë euro, komuniteti ka kontribuar me më tepër se 1 milion euro, Qeveria e Kosovës me 47,821.958 €, kurse donatorët kanë kontribuar me shumën financiare prej 21,4331.00 €. Në vitin 2017 janë realizuar 193 projekte me vlerë financiare prej 14,116.000 €, ku nga këto komuna ka participuar me 4,331.000, ndërkaq Qeveria e Kosovës 8,400,15000.00 €, dhe donatorët 1,369.000 €. Mandej ai njoftoi se në dorëzim-pranimin e detyrës tek kryetari i zgjedhur i komunës, atij i ka dorëzuar listën e projekteve të përfunduara, atyre që janë në zhvillim, si dhe atyre që janë planifikuar për të ardhmen. Në vazhdim shpalosi projekte të cilat

janë planifikuar e të cilat duhet të realizohen në të ardhmen, dhe atë në Drejtorinë e Shërbimeve Publike: implementimi i Planit për menaxhim të mbeturinave; grumbullimi i të hyrave vetanake nga komuna, nga familjet, bizneset, institucionet nga data 1 janar 2017; zgjedhja e problemit të Ndërmarrjes sociale për grumbullim, sortim dhe paketim të plastikës dhe metaleve të lehta në Bukosh (nëpërmes Ligjit për Ndërmarrjet Sociale ose Ankandit); kycja e sistemit të ujit të pijes nëpër familje, në bashkëpunim me Kompaninë Regjionale “Mitrovica” dhe rregullimi i varrezave të veteranëve të UÇK-së në vlerë 15,000 €. Në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural: jetësimi i projektit të Parkut të Biznesit në Lumadh (ekziston projekti detaj); jetësimi i projektit për Zonën Industriale në Banjskë, Sumë dhe Smrekonicë (ekziston kërkesa për kthim të tokës për pronësia e Ministrisë së Drejtësisë tek komuna – në Ministrinë e Drejtësisë) dhe vazhdimi i projekteve për sistemin e ujitjes. Në Drejtorinë Kadastër dhe Pronë: vazhdimi i projektit për futjen e të dhënave të komasacionit në sistem. Në Drejtorinë për Planifikim Urban dhe Mjedis: realizimi i projekteve planifikuese 2018–2020, realizimi i projekteve nga Ministria e Infrastrukturës, magjistratja Nedakoc - Vushtrri – Smrekonicë, rruga R- 220 Gllavatin – Bukosh, rruga Vushtrri – Pestovë – Nedakoc, Hartimi i Hartës Zonale. Në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale: kthimi i punëtorëve të QKMF –së nga emergjenca e spitalit në urgjencë të QKMF-së nga data 1 janar 2018 dhe funksionalizimi i Qendrës për fëmijë me nevoja të veçanta në Nedakoc. Pastaj në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport: vazhdimi i procedurës së tenderimit për Qendrën e Kulturës; funksionalizimi i muzeut të komunës; funksionalizimi i qendrës rinore; funksionalizimi i Kullës së Azem Bejtës dhe ndërtimi i lapidarit për dëshmorët e UÇK-së të ZOSH, në vlerë 30,000 €. Në Drejtorinë e Arsimit: zhvillimi i projekteve të planifikuara, lidhja e teorisë me praktikë, si dhe ngritja e cilësisë në mësim. Në fund të diskutimit të tij ai falënderoi të gjitha strukturat komunale për bashkëpunimin që kanë pasur gjatë gjithë këtyre viteve dhe i uroi sukses kryetarit të zgjedhur z. Xhafer Tahiri.

2. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë (pjesa zgjedhore).

Pas konsultimeve me grupet politike të përfaqësuara në kuvend, kryesuesi i mbledhjes së kuvendit konform Rregullores të punës së kuvendit, vendosi që kuvendi t’i zhvillojë punimet pa prezencën e publikut, për shkak të numrit të madh të qytetarëve dhe vështirësimit të zhvillimit të punimeve të mbledhjes.

Në vazhdim, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë me vota “unanime” formoi komisionin për verifikimin e procesit të votimit për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë në këtë përbërje:

Melihate Basholli, nga radhët e PDK-së;
Ymer Haradinaj nga radhët e LVV-së;
Shkelzen Feka nga radhët e LDK-së;
Berat Asllani nga radhët e AAK-së dhe
Fakete Dushi nga radhët e AKR-së.

Pastaj anëtarët e kuvendit paraqitën propozimet për kryesues të kuvendit:

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit - në emër të koalicionit: LDK, LVV, AAK, AKR dhe NISMA- propozoi Nasuf Aliun për Kryesues të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Sadije Bajgora, anëtare e kuvendit - nga radhët e LB-së propozoi Nezir Klinakun si kandidat për Kryesues të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Pas dhënies së propozimeve për kryesues të kuvendit, filloj procesi i votimit të fshehtë për zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, pas përfundimit të votimit, kandidati nga radhët e LB-së z. Nezir Klinaku mori 12 vota, kurse kandidati nga radhët e koalicionit, LDK, LVV, AAK, AKR dhe NISMA z. Nasuf Aliu mori 23 vota. Kështu që në këtë rast kryesuesi i mbledhjes konstatoi se Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë zgjidhet z. Nasuf Aliu:

1. Me këtë vendim Nasuf Aliu, anëtar i KK-së zgjedhet Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.
2. Mandati i të lartpërmendurit në cilësinë e kryesuesit të kuvendit të komunës përfundon në rastin e përfundimit të mandatit të anëtarëve të KK-së.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Sekretaria e kuvendit dhe menaxheri i personelit.
4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit në kuvendin e komunës dhe pas nënshkrimit nga kryesuesi (anëtari më i vjetër) i mbledhjes së kuvendit.

Nasuf Aliu, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë - pasi falënderoi anëtarët e kuvendit për besimin e dhënë që ai të jetë në krye të kuvendit, vlerësoi se ky moment paraqet një sfidë të re për karrierën e tij politike, moment aspak i lehtë e me shumë përgjegjësi. Në vazhdim ai falënderoi të gjithë intelektualët dhe të gjithë ata që kontribuuan për shtetin tonë, që ne sot frymojmë lirshëm jetojmë lirshëm dhe veprojmë lirshëm, andaj falënderim i veçantë për gjithë të rënë për lirinë e Kosovës. Pastaj ai falënderoi kryetarin Mulaku, për bashkëpunimin qeverisës që kanë pas përgjatë dhjetë viteve të fundit, por gjithashtu falënderoi edhe LDK-në dhe kryetarin e komunës Xhafer Tahirin. Në fund ai u zotua se nga pozicioni i kryesuesit të kuvendit do të angazhohet maksimalisht që të bien vendime që janë në interes të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë.

Mbledhja përfundoi në ora 13:30.

Bastri Duraku

Bajram Mulaku

Procesmbajtës

Anëtar i Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI

**DRAFT-PLANI
I PUNËS I KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË PËR
VITIN 2018**

Janar, 2018

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	3
Qëllimi.....	5
Janar.....	6
Shkurt.....	7
Mars	8
Prill.....	9
Maj	11
Qershor	12
Korrik.....	13
Gusht	14
Shtator.....	15
Tetor	16
Nëntor.....	17
Dhjetor	18

HYRJE

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në komunë dhe zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët dhe funksionon në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (LVL), Statutit të Komunës dhe akteve tjera nënligjore.

Kuvendi i komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për:

- Statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
- miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
- miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për kuvendin sipas Statutit apo Rregullores së punës;
- planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
- themelimin e komisioneve të kërkuara sipas këtij ligji;
- zgjedhjen e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të komunës;
- nivelin e tarifave dhe ngarkesave;
- krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- emërimin dhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike;
- arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brendakomunale;
- marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës;
- përgjegjësi të tjera që kërkohen me ligj.

Për marrjen e vendimeve, Kuvendi i komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij Komitetit të Kuvendit të komunës, apo kryetarit të komunës. Kuvendi i komunës mund të tërheqë delegimin në çdo kohë.

Komiteti për politikë dhe financa (KPF) është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, Kornizën vjetore buxhetore afatmesme, Planin vjetor të prokurimit, Rregulloren vjetore për tatimet, tarifrat dhe pagesat, Planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, për marrjen e raporteve nga kryetari, si dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e komunës.

Kuvendi i komunës siguron kushte të punës për mbajtje të mbledhjeve të Kuvendit të komunës, krijon hapësirë për pjesëmarrjen e qytetarëve gjatë mbledhjeve, siguron transparencë të plotë ndaj qytetarëve për të gjitha vendimet dhe aktet, si dhe për çdo gjë që është në interes të qytetarëve. Po ashtu, iu krijon mundësi qytetarëve që përmes formave të ndryshme të jenë pjesëmarrës në vendimmarrje.

Përveç këtyre akteve, Kuvendi i komunës kryen edhe aktivitete tjera që janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësiave të tij, përfshirë edhe funksione tjera, detyra dhe përgjegjësi të padeleguara si:

- Vendimet që kanë të bëjnë me pronën e komunës;
- Miratimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK);
- Miratimin e Planeve Strategjike të Zhvillimit Ekonomik Lokal etj.

Për marrjen e vendimeve, Kuvendi i komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij Komitetit të Kuvendit të komunës, apo kryetarit të komunës. Kuvendi i komunës mund të tërheqë delegimin në çdo kohë.

Plani i Punës i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë është dokument i mbështetur në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren për Punën e Kuvendit dhe Organeve të Tij dhe akteve tjera nënligjore. Plani është i hartuar në bazë të një kornize logjike, i cili planifikon etapa të realizimit të punëve dhe detyrave të kuvendit, të bazuara në përgjegjësitë që dalin nga legjislacioni në fuqi.

Me këtë plan synohet arritja e objektivave për vitin 2018, ku Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë planifikon t'i mbajë njëmbëdhjetë (11) mbledhje të rregullta, gjashtë prej të cilave në gjashtëmujorin e parë të vitit 2018, në të cilat do të trajtohen çështjet që janë në interes të komunës dhe të qytetarëve të saj, e të cilat do të procedohen sipas akteve në fuqi:

- Miraton buxhetin, planet investuese, Planin vjetor të prokurimit, Planin vjetor të punës së auditorit të brendshëm;
- Miraton çështjet tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për kuvendin, sipas Statutit apo Rregulloreve të punës;
- Nxjerr rregullore dhe bën harmonizimin e rregulloreve ekzistuese, sipas ligjeve në fuqi;
- Themelon komitetet këshillëdhënëse dhe trupa tjera ad hoc sipas nevojës;
- Planifikon shqyrtimin e raporteve të rregullta të punës së kryetarit të komunës sipas ligjit;
- Organizon takime buxhetore me qytetarë lidhur me planifikimin e buxhetit të komunës;
- Mbikëqyr, diskuton, analizon dhe vlerëson punën e ekzekutivit komunal.

QËLLIMI

Plani vjetor i punës i Kuvendit të komunës ka për qëllim që t'i ndihmojë dhe lehtësojë punimet e mbledhjeve të kuvendit, duke iu ofruar anëtarëve të kuvendit këtë plan, ku ata do ta kenë një pasqyrë për punët dhe aktivitetet e parapara për vitin 2018, e që kanë të bëjnë me interesat e qytetarëve.

Me këtë plan janë paraparë njëmbëdhjetë (11) mbledhje të rregullta, por sipas nevojës mund të mbahen edhe mbledhje të tjera, përfshirë mbledhjet e jashtëzakonshme, urgjente, solemne, siç parashihen me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës, Udhëzimin Administrativ për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Dinamika e Planit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë do të realizohet në bazë të orarit të mbledhjeve të kuvendit, të miratuara në mbledhjen e parë të kuvendit në vitin 2018, që përfshin edhe orarin e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi i kuvendit mban takime mujore ose sipas nevojës me shefat e grupeve kuvendare të subjekteve politike të përfaqësuara në kuvend, me qëllim të bashkërendimit të punës në komitetet e përhershme.

Për përmbushjen e planit të punës, ekzekutivi iu ofron mbështetje profesionale dhe administrative organeve të kuvendit, duke përshtatur organizimin e brendshëm për realizimin e objektivave dhe agjendës, sipas këtij plani.

Për mbarëvajtjen e zbatimit të të gjitha aktiviteteve sipas dinamikës, të përcaktuara me këtë plan do të përkujdesen: kryetari i komunës, kryesuesi i kuvendit dhe sekretaria e kuvendit.

Realizimi i planit të punës së kuvendit kërkon bashkërenditje dhe koordinim të aktiviteteve me ekzekutivin e komunës, e cila duhet t'i përmbahet planit të kuvendit për vitin 2018.

Plani i punës i kuvendit sipas dinamikës mujore përfshin: emërtimin e aktit, propozuesin, afatin e dërgimit nga propozuesi, afatet e shqyrtimeve nga komitetet e përhershme përgjegjëse për shqyrtim.

Plani i punës i kuvendit për vitin 2018 do të plotësohet edhe me:

- miratimin e iniciativave për bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkombëtar;
- propozime për debate të ndryshme;
- propozime për raportime dhe informata;
- peticione;
- pyetje të anëtarëve të kuvendit.

Shtojcë: Plani i punës sipas muajve

Vushtrri

Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit

**DRAFT-PLANI
I PUNËS I KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË PËR VITIN 2018**

JANAR

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Propozim-vendim për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa	Kryesuesi i Kuvendit	Kryetari i Komunës	15.01.2018
2.	Draft-Plani i punës i Kryetarit për vitin 2018	Kryetari i Komunës		15.01.2018
3.	Raport tremujor mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore	Kryetari i Komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	15.01.2018
4.	Plani i veprimit mbi rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm			15.01.2018
5.	Propozim-vendim për formimin e komisionit për ndarjen e bursave për studentë dhe shpërblime për nxënës	Drejtoria për Arsim		15.01.2018
6.	Të ndryshme			

SHKURT

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Propozim-vendim për themelimin e Komitetit për Komunitete	Kryesuesi i Kuvendit	Kryetari i Komunës	
2.	Propozim-vendim për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)	Kryetari i Komunës		05.02.2018
3.	Propozim-vendim për ndarjen e subvencioneve	Kryetari i Komunës	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	05.02.2018
4.	Informatë për gjendjen në shëndetësi	Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale		05.02.2018
5.	Informatë për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2017/2018	Drejtoria për Arsim		05.02.2018
6.	Raport Vjetor për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2017	Komandanti i Stacionit Policor në Vushtrri		05.02.2018
7.	Draft-Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa dhe ngarkesa komunale	Drejtoria për Buxhet dhe Financa		05.02.2018
8.	Bartja e të hyrave vetanake nga viti 2017 në vitin 2018	Drejtoria për Buxhet dhe Financa		
9.	Të ndryshme			

MARS

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Raport për situatën ekonomiko- financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2017	Kryetari i Komunës		09.03.2018
2.	Draft-Rregullore për mënyrën e mbulimit të shpenzimeve të varrimit për familjet e dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës së UÇK-së	Drejtoria për Shërbime Publike		09.03.2018
3.	Draft-Rregullore për caktimin e kriterëve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për ndihmë momentale entiteteve publike dhe jo publike	Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale		09.03.2018
4.	Raport vjetor i Ndërmarrjes Regjionale “Uniteti”	Ndërmarrja Regjionale “Uniteti”		09.03.2018
5.	Raport vjetor i Ndërmarrjes Regjionale “Ujësjetësi”	Ndërmarrja Regjionale “Ujësjetësi”		09.03.2018
6.	Informatë rreth procedurës së legalizimit të objekteve	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit		09.03.2018
7.	Të ndryshme			

PRILL

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Raport tremujor mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore	Kryetari i Komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	09.04.2018
2.	Draft -Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Vushtrrisë	Drejtoria për Administratë		09.04.2018
3.	Informatë lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë	Drejtoria për Inspektive		09.04.2018
4.	Informatë tremujore për sigurinë ushqimore	Drejtoria për Inspektive		09.04.2018
5.	Informatë për gjendjen sociale në Komunën e Vushtrrisë	Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale		09.04.2018
6.	Informatë lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të tokave bujqësore	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit		09.04.2018
7.	Raport vjetor i Komitetit Konsultativ për Arsim, Kulturë, Fe, Sport dhe Rini	Komiteti Konsultativ për Arsim, Kulturë, Fe, Sport dhe Rini		09.04.2018
8.	Raport vjetor i Komitetit Konsultativ për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore	Komiteti Konsultativ për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore		09.04.2018
9.	Raport vjetor i Komitetit Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale	Komiteti Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale		09.04.2018

10.	Raport vjetor i Komitetit Konsultativ për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Ambientit	Komiteti Konsultativ për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Ambientit		09.04.2018
11.	Raport vjetor i Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike	Komiteti Konsultativ për Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike		09.04.2018
12.	Raport vjetor i Komitetit Konsultativ për Persona me Nevoja të Veçanta	Komiteti Konsultativ për Persona me Nevoja të Veçanta		09.04.2018
13.	Të ndryshme			

MAJ

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Propozim- vendim për ndarjen e dekoratave dhe mirënjohjeve	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	Komisioni për ndarjen e mirënjohjeve dhe dekoratave	09.05.2018
2.	Informatë lidhur me qarkoren buxhetore 2018 dhe miratimi i planit të veprimit për dëgjimet publike	Drejtoria për Buxhet dhe Financa		09.05.2018
3.	Informatë lidhur me zhvillimin dhe realizimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive, duke përfshirë teatrin, bibliotekën dhe muzeun	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport		09.05.2018
4.	Informatë lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrrisë	Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural		09.05.2018
5.	Informatë për ndarjen e bursave dhe shpërblimet e nxënësve për vitin 2017/2018	Drejtoria për Arsim		09.05.2018
6.	Të ndryshme			

QERSHOR

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Draft Korniza Afatmesme (KAB) për vitet 2019-2021	Drejtoria për Buxhet dhe Financa		07.06.2018
2.	Informatë lidhur me inspektimin e bizneseve në Komunën e Vushtrrisë	Drejtoria për Inspektime		07.06.2018
3.	Informatë për shfrytëzimin e pasurisë së komunës	Kryetari i Komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	07.06.2018
4.	Informatë nga Drejtoria për Administratë	Drejtoria për Administratë		07.06.2018
5.	Të ndryshme			

KORRIK

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Shqyrtimi i parë i Draft-Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2019	Drejtoria për Buxhet dhe Financa		04.07.2018
2.	Informatë lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës për periudhën janar-qershor 2018	Kryetari i Komunës		04.07.2018
3.	Njoftim për Kuvendin e Komunës lidhur me raportin e auditorit të përgjithshëm për pasqyrat financiare për vitin 2017	Kryetari i Komunës		04.07.2018
4.	Raport tremujor mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore	Kryetari i Komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	04.07.2018
5.	Informatë për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2017/2018	Drejtoria për Arsim		04.07.2018
6.	Informatë për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar-qershor 2018	Komandanti i stacionit policor		04.07.2018
7.	Informatë tremujore për sigurinë ushqimore	Drejtoria për Inspektive		04.07.2018
8.	Pasqyrat financiare për vitin 2017 dhe raporti i auditorit	Kryetari i Komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	
9.	Të ndryshme			

GUSHT

MUAJ I PUSHIMEVE

SHTATOR

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Shqyrtimi i draft- buxhetit dhe planeve investuese për vitin 2019	Kryetari i Komunës		05.09.2018
2.	Shqyrtimi i dytë i Draft-Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2019	Drejtoria për Buxhet dhe Financa		05.09.2018
3.	Raport për situatën ekonomiko- financiare dhe zbatimin e planeve investuese në gjashtëmujorin e parë të vitit 2018	Kryetari i Komunës		05.09.2018
4.	Informatë për përfundimin e vitit shkollor 2017/2018 dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2018/2019	Drejtoria për Arsim		05.09.2018
5.	Informatë për përfundimin e korrje-shirjeve dhe përgatitjet për mbjelljet vjeshtore	Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural		05.09.2018
6.	Të ndryshme			

TETOR

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Raport tremujor mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore	Kryetari i Komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	03.10.2018
2.	Informatë lidhur me nivelin e pastërtisë dhe eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave për tërë territorin e komunës	Drejtoria për Shërbime Publike		03.10.2018
4.	Të ndryshme			

NËNTOR

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Informatë për gjendjen shëndetësore të qytetarëve në Komunën e Vushtrrisë	Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale		07.11.2018
2.	Informatë lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve dhe zhvillimin e bizneseve	Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural		07.11.2018
3.	Informatë lidhur me zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit		07.11.2018
4.	Informatë lidhur me mbrojtjen e ambientit	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit		07.11.2018
5.	Informatë tremujore për sigurinë ushqimore	Drejtoria për Inspektive		07.11.2018
6.	Të ndryshme			

DHJETOR

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Informatë lidhur me mirëqenien sociale: strehim familjar, përkujdesjen për të moshuarit	Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale		05.12.2018
2.	Draft-Plani i Punës i Kuvendit të Komunës të Vushtrrisë për vitin 2019	Kryesuesi i Kuvendit		05.12.2018
3.	Informatë nga Drejtoria për Administratë	Drejtoria për Administratë		05.12.2018
4.	Të ndryshme			



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



PLANI I PUNËS PËR VITIN 2018

**Vushtrri,
Janar 2018**

Hyrje

Qeverisja e re në Komunën e Vushtrrisë për qëllim dhe synim të saj parësor ka rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe cilësisë së shërbimeve të komunës për qytetarin. Ky plan synon të ofrojë një shancë të barabartë për të gjithë qytetarët e komunës, është një udhërrëfyes për një komunë të hapur dhe të barabartë për të gjithë qytetarët e komunës.

Kryetari i Komunës i ushtron kompetencat dhe përgjegjësitë e tij në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, Statutin e komunës, vendimet e Kuvendit të komunës dhe aktet tjera nënligjore, gjithnjë duke pasur parasysh interesin për komunën dhe për qytetarin.

Plani i punës i Kryetarit të Komunës, shërben si dokument bazë për punën njëvjeçare të Kryetarit dhe të qeverisë komunale, i cili është një reflektim i angazhimit të vazhdueshëm për t'i kanalizuar nismat për planifikim të objektivave, përkatësisht prioritetëve, të cilat do të mund të realizohen bazuar në planifikimin buxhetor të vitit 2018, e që ka për qëllim final përmirësimin e cilësisë së jetësës për të gjithë qytetarët në komunën tonë.

Ky plan i punës përmban objektiva afatgjate përmes të cilave synohet të vihen themelet e transformimit të qytetit të Vushtrrisë në një qytet modern, por që ruan traditën dhe identitetin e vet. Realizimi i tyre do të fillojë në vitin 2018, por përmbyllja e tyre do të marrë kohën e vet.

Po ashtu plani përmban edhe projekte konkrete, si dhe veprime specifike si në administratë ashtu edhe në infrastrukturë, por që janë pashmangshëm të ndikuara nga planifikimi buxhetor i qeverisjes së kaluar, i hartuar e aprovuar në vitin paraprak.

Ky plan i punës ka kufizimet e veta, kurse kufizimi kryesor ka të bëjë me atë se planifikimi buxhetor është hartuar nga qeverisja e kaluar, prandaj disa nga pikat e planit të punës do të fillojnë të implementohen vetëm pas rishikimit buxhetor.

Përmbushja e këtij plani të punës natyrisht që i ka edhe sfidat e veta gjatë përmbushjes së këtyre objektivave, por besoj shumë që me një angazhim të përbashkët mund të arrihen rezultatet konkrete dhe të përmirësohet cilësia e shërbimeve në komunë, por edhe të përmirësohet mirëqenia e qytetarit të Vushtrrisë.

Gjithashtu ky plan i punës paraqet prioritetet e Kryetarit të komunës dhe Qeverisë komunale për vitin 2018 dhe jep përmbledhje të objektivave, aktiviteteve të planifikuara dhe realizimin e tyre, duke i përcaktuar natyrisht edhe afatet kohore për kryerjen e secilit prej aktiviteteve dhe objektivave të parapara. Plani është dinamik dhe mund të plotësohet gjatë gjithë vitit, duke synuar arritjen e objektivave të reja.

Prioritetet kryesore të Kryetarit Xhafer Tahiri për vitin 2018:

1. Menaxhimi efektiv dhe transparent i buxhetit të komunës, si dhe rritja e të hyrave vetanake të komunës;
2. Transparenca në shpenzime dhe llogaridhënie, efikasiteti lidhur punën e organeve të komunës, digjitalizimi i shërbimeve në administratë si dhe eliminimi i pritjeve të qytetarëve për të marrë dokumentet që i kërkojnë nga komuna;
3. Realizimi i të hyrave të planifikuara buxhetore, si dhe të gjitha formave dhe mundësive të burimeve tjera të të hyrave;
4. Rritja e të hyrave vetanake të komunës;
5. Furnizimi me ujë në qytet dhe në fshatra;
6. Angazhimet për funksionalizmin e zonës ekonomike/parkut të biznesit në Lumadh;
7. Inicimi i studimit të fizibilitetit për Qendrën Historike të Vushtrrisë;
8. Inicimi i studimit të fizibilitetit për tregun për prodhuesit vendor;
9. Ngritja e cilësisë në arsim, ngritja e sigurisë, si dhe luftimi i dukurive devijante në shkolla, ngritja e cilësisë së punës në institucionet e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm;
10. Investimet në bujqësi me qëllim të rritjes së prodhimtarisë bujqësore, përmirësimi i cilësisë së atyre prodhimeve, rritjes së vetëpunësimit, modernizimit të bujqësisë përmes organizimit, trajnimeve dhe këshillimeve profesionale, si dhe subvencionimit të bujqëve;
11. Përkrahja për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe startupet me qëllim të rritjes së punësimit dhe zhvillimit ekonomik;
12. Funksionalizimi i Qendrës Inovative të Vushtrrisë;
13. Avancimi i infrastrukturës sportive;
14. Organizimi i festivalit të kulturës dhe diasporës “Viciania”;
15. Organizimi i “Panairit të Patates”;
16. Organizimi i praktikës së punës për të rinjtë;
17. Inicimi i planit pesëvjeçar për adresim të strehimit për familjet pa strehim;
18. Zbatimi i kriterëve ligjore, nevojave të qytetarëve në urbanizëm, si dhe vendosja e rendit dhe ligjit në ndërtimet e larta;
19. Fillimi i implementimit të pagesës për shpenzimet e varrimit;
20. Implementimi i planit për pastërtinë në qytet – heqja e monopoleve, hapja e tregut dhe futja e konkurrencës;
21. Reduktimi i shpenzimeve dhe shfrytëzimi racional i mjeteve buxhetore, përkatësisht shpenzimeve buxhetore;
22. Raportimi i rregullt në Kuvendin e Komunës (çdo 3 muaj) lidhur me të hyrat dhe shpenzimet buxhetore sipas nevojës edhe sipas kërkesës së Kuvendit;
23. Realizimi i projekteve kapitale sipas planifikimit në kohë, angazhimi për shpenzime 100 % të mjeteve financiare në kategorinë e investimeve kapitale, sidomos mjeteve të grantit qeveritar me qëllim të zhvillimit të qytetit;
24. Intensifikimi i bashkëpunimit me organet e nivelit qendror në implementimin e projekteve, të cilat janë paraparë të financohen nga buxheti i Republikës së Kosovës, në veçanti projektet dy apo trivjeçare;
25. Shfrytëzimi racional, i drejtë dhe i ligjshëm i pronave (tokave dhe objekteve) në pronësi të komunës përmes dhënies në shfrytëzim, me qëllim të zhvillimit ekonomik dhe të krijimit të

- të hyrave buxhetore;
26. Ndërmarrja e masave për lirim të pronave komunale të uzurpuara;
 27. Përkushtimi për hapjen e mundësive si dhe për gjetjen e donatorëve për investime në komunë, në veçanti në sektorin e bujqësisë;
 28. Implementimi i projektit për zgjerimin e sistemit të ujitjes nga hidrosistemi „Ibër Lepenc“ në fsh.Samadrexhë dhe Pantinë;
 29. Mbrojtja e pyejeve, rritja e hapësirave gjelbëruese në qytet;
 30. Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve në zonat rurale;
 31. Angazhimet për gjetjen e donatorëve për investime në ndërtimin e kolektorit kryesor buzë lumit „Silnica“ dhe impiantit për punimin e ujërave të zeza;
 32. Menaxhim më i mirë i mbeturinave, duke marrë për bazë planin tanimë të aprovuar për menaxhimin e mbeturinave,
 33. Ofrimi i shërbimeve sa më cilësorë ndaj qytetarëve për sa i përket lëshuarjes së dokumenteve personale;
 34. Ngritja e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore;
 35. Promovimi, përkatësisht avancimi i aktiviteteve kulturore të rinisë dhe në lëmin e sportit;
 36. Përmirësimi i kushteve të jetesës të banorëve në zonat rurale;
 37. Ofrimi i mbështetjes i klubeve sportive, organizatave të dala nga lufta, organizatave rinore, OJQ –ve tjera të komunës, si dhe kategorive tjera në veçanti familjeve skamnore;
 38. Bashkëpunimi me organet e nivelit qendror, veçanërisht me qeverinë dhe ministrinë e linjes në aspektin e zbatimit të ligjshmërisë, në rastin e marrjes së vendimeve me rëndësi dhe interes për komunën dhe qytetarët;
 39. Bashkëpunimi me KFOR-in, Policinë e Kosovës, FSK-në në aspektin e sigurisë së përgjithshme;
 40. Bashkëpunimi me shoqërinë civile në aspektin e krijimit të mundësive për pjesëmarrje në proceset e vendimmarrjes në komunë.

Objektivat, veprimet konkrete për realizimin e tyre, si dhe afatet kohore të realizimit, paraqitur në formë tabelare sipas dikastereve që aktualisht janë të ndara me Statut të komunës

Ekonomi, Bujqësi dhe Pylltari

Në vijim do të paraqiten në formë tabelare punët dhe aktivitetet si dhe planifikimi i realizimit buxhetor:

Objektivat:	Aktivitetet	Kosto në €	Përfitues	Periodha kohore	Veprimet
<p>- Investimet në bujqësi me qëllim të rritjes së prodhimitarisë bujqësore, përmirësimi i cilësisë së atyre prodhimeve, rritjes së vetëpunësimit, modernizimit të bujqësisë përmes organizimit i trajnimeve dhe këshillimeve profesionale, si dhe subvencionimit të bujqëve;</p> <p>- Përkrahja për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe startupet me qëllim të rritjes së punësimit dhe zhvillimit ekonomik;</p>	Zhvillimi i aktiviteteve dhe përpjekjet për kushte më të mira në QKB			Gjithë vitin	Angazhimet në zvogëlimin dhe eliminimin e të gjitha barrierave për të bërë biznes, në shkurtim të kohës për regjistrim të biznesit
	Përkrahja e bizneseve	90.000	bizneset	Gjithë vitin	Zhvillimi i tyre
	Rregullimi i lumenjve dhe argjinaturave	20.000	pronarët e tokave bujqësore	Qershor-Shtator/2018	Me këtë projekt synohet që të ndikohet në ruajtjen e tokave bujqësore, duke parandaluar dëmet nga vërshimet
	Makina për nxerrjen e patateve	15.000	fermerët	Janar-Tetor/2018	Ky projekt lehtëson punët në kultivim të kulturave bujqësore
	Makina për nxerrjen e qepëve	15.000	fermerët	Shkurt/2018	Ky projekt lehtëson punët në kultivim të kulturave bujqësore
	Makina për konzervimin e barit (rrotoballer)	30.000	fermerët		Rritja dhe forcimi i ekonomive familjare në sektor të bujqësisë
	Makina për shpërndarjen e plehut organik	30.000	bujqit		Këtë projekt synojmë ta realizojmë me bashkëfinancim me fermerët
	Ndërtimi i serrave	51,000	fermerët	Shtator/2018	Ky projekt synohet që të realizohet në bashkëpunim me ndonjë donator, si dhe me bashkëfinancim nga ana e vet fermerëve.
	Mbulimi i normave të	100,000			Me këto mjete synohet që të....

	interesit për biznese të reja				
	Projektet në bashkëfinancim me donatorë (bujqësi)	50.000	bujqit		Ndikon në zhvillimin e bujqësisë e me këtë edhe në zhvillimin ekonomik të vendit
	“Dita e patates”			1-10/Tetor /2018	Ka karakter të promovimit të kësaj kulture nga fermerë të vyeshëm, sukseseve të kompanisë ”Pestova”, si dhe paraqitjen e inovacioneve teknologjike.
	Mbjelljet pranverore/vjeshtore			- Shkurt/prill Shtator / nëntor /2018	Përcjellje e fushatës së mbjelljeve, dhe raportimi për sipërfaqet e mbjellura
	Korrje-shirjet			Korrik / gusht /2018	komisionin do të përcjell fushatën e korrje shirjeve dhe raportoj për rendimentet e arritura.
	Subvencionimi i kulturave lavërtarë, si dhe kafshëve shtëpiake		bujqit	Pranverë / vjeshtë / 2018	Subvencionimi i grurit, misrit, sojës dhe lulediellit si dhe të gjedheve, deleve, dhive dhe bletëve,
	Grantet në bujqësi		bujqit	Pranverë/ verë / 2018	Thirrja për aplikim në grante
	Pastrimi i pyjeve		Pronarët e pyjeve	Pranverë/ vjeshtë / 2018	Oblveik dhe Vesekoc
	GJITHSEJ:	401.00 0 €			

❖ **Buxhet dhe financa**

Objektivat	Aktivitetet	Afati	Ecuria	Pjesëmarrësit tjerë	Ndërlidhja
Përgatitjet fillestare për fillimin e sistemit të pagesave (Free Balanc) për vitin fiskal 2018.	Kompletimi i dokumentacionit për të gjitha programet buxhetore dhe monitorimi i tyre	Janar / 2018		Të gjitha programet buxhetore të drejtorive	Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
Autorizimet e veçanta për: nëpunësin administrativ të pagesave, personin autorizues, personin aprovues, personin zotues dhe certifikuesi për periudhën 2018.	Plotësimi i kërkesës për qasje të përdoruesve në SIMFK	Janar / 2018	Sipas planit të rrjedhës së parasë së gatshme		Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
3.Pasqyrat financiare të buxhetit për vitin 2017	Plotësimi më efikas dhe dorëzimi i PVF	Janar / 2018			
Përgatitja e rrjedhës së parasë për të gjitha programet për vitin 2018	Plotësimi i formularëve të rrjedhës së parasë në bazë të planifikimit të buxhetit në MEF	Janar / 2018			
Bartja e të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti 2017	Implementimi i të hyrave të bartura në vitin 2018	Shkurtmars / 2018			

Përgatitja e listave për të hyrat e pa arkëtuara të taksës në firmë	Evidentimi i të gjitha bizneseve që ushtrojnë veprimtarin e tyre lidhur me të hyrat e pa arkëtuara për ngarkesën e taksës në firmë	Shkurt/2018			
Përgatitjet e duhura për realizimin e projekteve të pa kryera nga viti 2017 (projektet investuese).	Kompletimi i dokumentacionit për zotimin e mjeteve	Shkurt-Mars/2018			
Barazimi mujor i shpenzimeve në sistemin FB	Përmbajtja e afatit kohor në bazë të Udhëzimit administrativ 02/2010	Çdo muaj/2018			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave vetanake për tremujorin e parë.	Përgatitja e informatës lidhur me realizimin e buxhetit dhe inkasimin e të hyrave për të gjitha programet buxhetor	Çdo tre muaj/2018			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
Prezantimi i Qarkores 01/2018 kufijve të parë buxhetor dhe përpunimi i buxhetit për vitin 2018 konform qarkoreve nga MEF-i	Harmonizimi i kërkesave të drejtorive për ndryshimin eventual të buxhetit të rishikuar për vitin fiskal 2018	Maj-Qershor/2018			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive

	Harmonizimi i kërkesave të drejtorive për ndryshimin eventual të buxhetit të rishikuar për vitin fiskal 2018	Qershor /2018			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
Përgatitjet për rishikimin buxhetor (varësisht nga kërkesat e MEF-it)	Përgaditja e formularëve lidhur ndryshimet buxhetore	Qershor - Korrik/ 2018			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
Përcjellja e realizimit të shpenzimeve buxhetore sipas dinamikës së paraparë për gjashtëmujorin e parë për vitin fiskal 2018	Raportimi lidhur me projektet e realizuara në bazë të planifikimit të buxhetit	Qershor /2018			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
Informatë për realizimin e investimeve kapitale të parapara me planin dinamik të shpenzimeve.	Përgaditja e informatë lidhur me shpenzimet buxhetore	Korrik/ 2018			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
15.Shqyrtimi i rregullores së tatimit në pronë për vitin 2019	15.Dorzimi në MEF	Korrik/ 2018			
Përgatitja e tregueseve final buxhetor për vitin 2019 konform qarkores nga MEF-i	Evidentimi i të gjitha kërkesave të drejtorive për vitin fiskal 2019.	Shtator/ 2018			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
17.Përgatitjet për përmbylljen e vitit fiskal buxhetor 2018		Dhjet or/2018			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive

❖ Prokurimi Publik

Me këtë Plan identifikohen në detaje të gjitha aktivitetet e prokurimit që Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrisë planifikon t'i realizoi gjatë vitit fiskal 2018, për gjitha kategoritë.

KONTRATAT PËR FURNIZIM

Nr.	Përshkrimi i furnizimeve	Vlera e parashikuar e kontratës	Data e fillimit	Bartës të aktivitetit (Njësia kërkuese)
1	Furnizim me materjal zyrtar	80.270,00 €	2018	gjitha drejtoritë
2	Furnizimi me naft dhe derivate të naftës	140.707,00 €	2018	Administrata, Shërbimet Publike, QKMF, Kultura, Arsimi, zjarrfikësat
3	Furnizim me materiale të shtypura për zyre	6,300.00	2018	Gjitha drejtoritë
4	Furnizimi me orendi për zyre	12,514.00	2018	Gjitha drejtoritë
5	Furnizimi me pajisje tjera	15,884.00	2018	Gjitha drejtoritë
6	Furnizimi me veshmbathje	19,800.00	2018	Zyra e kryetarit, shërbimet publike, inspekcioni, DBTHF, zjarrfikësat
7	Furnizimi me ushqim dhe pije	63,200.00	2018	Zyra e kryetarit, shëndetësia, kultura, zjarrfikësat, arsimi, shtëpia rezidenciale në Lum Madh
8	Furnizimi me material higjienik	44,906.00	2018	Administrata, shëndetësia, arsimi, kultura, zjarrfikësat, shtëpia rezidenciale në Lum Madh
9	Furnizimi me material për mirëmbajtje të objekteve të AK	20,131.00	2018	Administrata, arsimi, shëndetësia, shtëpia rezidenciale në Lum Madh, zjarrfikësat
10	Furnizimi me teknologji informative dhe pajisje të teknologjisë informative	25,293.00	2018	Zyra e kryetarit, kryesuesit të K.K.-së, shërbimet publike, administrata, shtëpia rezidenciale në Lum Madh, arsimi,
11	Furnizimi me dru për ngrohje	77,500.00	2018	Arsimi, shëndetësia
12	Furnizimi me thëngjill për ngrohje	54,800.00	2018	Arsimi
13	Furnizimi me aparate fotokopjuese	3,410.00	2018	Arsimi, shtëpia rezidenciale në Lum Madh
14	Furnizimi me inventar për shkolla	30,000.00	2018	Arsimi
15	Furnizimi me inventar për objektin e ri të komunës	35,000.00	2018	Administrata
16	Furnizimi me medikamente dhe material shpenzues medicinal për QKMF-re	38,307.00	2018	QKMF-re
17	Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve të	20,000.00	2018	QKMF-re

	sistemit për menaxhimin e rendit			
18	Furnizimi me pajisje speciale mjeksore	1,380.00	2018	shtëpia rezidenciale në Lum Madh
19	Furnizimi me aparatur dhe mjete pune për QKMF-re	21,600.00	2018	QKMF-re
20	Furnizim me inventar për QKMF	5,000.00	2018	QKMF-re
21	Furnizimi me automjetë(Autoambulancë)	80,000.00	2018	QKMF-re
22	Furnizimi me automjetë tereni me 5 ulëse dhe rimorkio	28,000.00	2018	QKMF-re
23	Furnizimi dhe vendosja e kamerave në qytet	10,000.00	2018	Shërbimet publike
24	Furnizimi me gypa për kanalizime të ujrave të zeza	40,000.00	2018	Shërbimet publike
25	Furnizimi me kontejnerë për mbeturina	25,000.00	2018	Shërbimet publike
26	Furnizim me pajisje për zjarrfikës	4,100.00	2018	Njësia e zjarrfikësve
27	Furnizimi me libra për bibliotekë	25,000.00	2018	Kultura
28	Furnizimi me paisje për muazeun e qytetit	16,000.00	2018	Kultura
29	Furnizimi me paisje për muazeun- zyren e turizmit	15,000.00	2018	Kultura
30	Furnizimi me pajisje laboratorike për shkolla	25,000.00	2018	Arsimi
31	Furnizimi me pajisje për shkolla	29,261.00	2018	Arsimi
32	Furnizim me pajisje për qendren rinore	20,000.00	2018	Kultura
33	Furnizimi me makina për nxerrjen e patateve	15,000.00	2018	Ekonomi- Bujqësi
34	Furnizimi me makina për nxerrjen e qepëve	15,000.00	2018	Ekonomi- Bujqësi
35	Furnizimi me makina për konzervimin e barit (rrotoballer)	30,000.00	2018	Ekonomi- Bujqësi
36	Furnizimi me makina për shpërndarjen e plehut organik	30,000.00	2018	Ekonomi- Bujqësi
37	Furnizim me preparatete kimike	1,100.00	2018	Arsimi
	Totali:	1.124.463,00€		

KONTRATAT PËR SHERBIME

Nr.	Përshkrimi i Kontratës	Vlera e parashikuar e kontratës (€)	Data e fillimit	Bartës të aktivitetit
1	Servisimi i teknologjisë informative	5,350.00	2018	Gjitha drejtoritë
2	Botimet e reklamave dhe konkurësive	6,450.00	2018	Zyra e kryetarit, administrate, arsimi, shëndetësia

3	Riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve	42,200.00	2018	Shërbimet publike, shëndetësia, zjarrfikësat, arsimi, shtëpia rezidenciale në Lum Madh
4	Shërbimet e internetit	3,470.00	2018	Arsimi
5	Shërbimet hoteliere	14,810.00	2018	Zyra e kryetarit, kryesuesi i KK-së, administrate, arsimi
6	Sigurimi fizik i objekteve komunale, shkollave, QPS-le dhe QKMF-re	288,000.00	2018	Administrata, shëndetësia, arsimi
7	Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve të AK-Vushtrri	182,400.00	2018	Administrata, shëndetësia, arsimi
8	Transporti i nxënësve	139,995.00	2018	Arsimi
9	Pastrimi dhe larja e rrugëve të qytetit	72,000.00	2018	Shërbimet publike
10	Shërbime tjera kontraktuese	235,559.00	2018	Gjitha drejtoritë
11	Menaxhimi i mbeturinave	622,089.00	2018	Shërbimet publike
12	Shërbimet e udhimit jashtë vendit	13,200.00	2018	Zyra e kryetarit dhe drejtori tjera
13	Shërbimet e ndryshme shëndetsore	8,100.00	2018	QKMF-re
14	kontrolli teknik i automjeteve	1,600.00	2018	Shërbimet publike
15	Hartimi i projekteve	100,000.00	2018	Urbanizmi
16	Rrjeta gjeodezike	20,000.00	2018	Kadastrri
17	Shtypja e materialeve të nevojshme për AK - Vushtrri	2,100.00	2018	Gjitha drejtoritë
18	Shërbimet e udhimit brenda vendit	1,000.00	2018	Administrata, arsimi
19	Mbulimi i normave të interesit për bizneset e reja	100,000.00	2018	Ekonomi – bujqësi
20	Mirëmbajtje e mobiljeve dhe pajisjeve	17,720.00	2018	Gjitha drejtoritë
		1.876.043,00 €		

KONTRATAT PËR PUNË

Nr.	Përshkrimi i Kontratës	Vlera e kontratës (€)	Data e parashikuar e fillimit	Bartës të aktivitetit
1	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Novolan (dy vjeçar)	43,500.00	2018	urbanizmi
2	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Smrekonicë (dy vjeçar)	36,400.00	2018	urbanizmi
3	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Bequk	25,200.00	2018	urbanizmi
4	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Galicë (dy vjeçar)	38,220.00	2018	urbanizmi
5	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Bruznik (dy vjeçar)	66,700.00	2018	urbanizmi
6	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Maxhunaj (tre vjeçar)	114,520.00	2018	urbanizmi
7	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Samadrexhë	27,720.00	2018	urbanizmi
8	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Reznik (lagja Mustaf, Curri dhe Makiqi) dhe në fshatin Shalc (tre vjeçar)	124,740.00	2018	urbanizmi
9	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Sllakoc (tre vjeçar)	303,940.00	2018	urbanizmi
10	Asfaltimi i rrugës Vushtrri -Nadakoc-Pestovë (tre vjeçar)	1,188,980.00	2018	urbanizmi
11	Asfaltimi i rrugës Sllatinë-Tërllabuq (dy vjeçar)	56,000.00	2018	urbanizmi
12	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Pantinë (dy vjeçar)	75,600.00	2018	urbanizmi
13	Asfaltimi i rrugës Stanoc-Lum Madh-Prelluzhë-Gracë (dy vjeçar)	150,000.00	2018	urbanizmi
14	Asfaltimi i rrugëve lokale në tri Dumnicat (tre vjeçar)	128,260.00	2018	urbanizmi

15	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Ropicë	10,500.00	2018	urbanizmi
16	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Ceceli (dy vjeçar)	235,020.00	2018	urbanizmi
17	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Studime e Epërme (dy vjeçar)	31,000.00	2018	urbanizmi
18	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Studime e Poshtme (dy vjeçar)	29,400.00	2018	urbanizmi
19	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Sfaraqak (dy vjeçar)	61,600.00	2018	urbanizmi
20	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Akrashticë (tre vjeçar)	74,340.00	2018	urbanizmi
21	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Pestovë	16,422.00	2018	urbanizmi
22	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Banjskë (dy vjeçar)	40,000.00	2018	urbanizmi
23	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Dobërllukë (tre vjeçar)	91,520.00	2018	urbanizmi
24	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Bukosh	21,000.00	2018	urbanizmi
25	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Vërnice	10,500.00	2018	urbanizmi
26	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Duboc (dy vjeçar)	27,720.00	2018	urbanizmi
27	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Beçiq (dy vjeçar)	24,360.00	2018	urbanizmi
28	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Shallc (dy vjeçar)	23,100.00	2018	urbanizmi
29	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Pasomë (dy vjeçar)	21,420.00	2018	urbanizmi
30	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Ashlan (dy vjeçar)	42,000.00	2018	urbanizmi

31	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Mihaliq (dy vjeçar)	59,640.00	2018	urbanizmi
32	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Stroc	10,920.00	2018	urbanizmi
33	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Bivolak (dy vjeçar)	16,800.00	2018	urbanizmi
34	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatinë Balincë	42,000.00	2018	urbanizmi
35	Rrugët e rendit të katërt	80,000.00	2018	Shërbimet publike
36	Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni	161,779.00	2018	Shërbimet publike
37	Ndërtimi i trotuareve	80,000.00	2018	Shërbimet publike
38	Ndërtimi i kanalizimeve	262,000.00	2018	Shërbimet publike
39	Ndriçimi Publik	20,000.00	2018	Shërbimet publike
40	Rikonstruimi i rrugëve të asfaltuara	166,364.00	2018	Shërbimet publike
41	Projektet në bashkëfinancim me donator	100,000.00	2018	Shërbimet publike
42	Ndërtimi i parçeve	20,000.00	2018	Shërbimet publike
43	Ndërtimi i banesave për familjet e dëshmorëve, invalid të luftës së UÇK-së (tre vjeçar)	530,000.00	2018	Shërbimet publike
f44	Ndërtimi i urës në fshatin Dobërllukë	20,000.00	2018	Shërbimet publike
45	Platoja dhe gjelbrimi te banesat e bardha (tre vjeçar)	315,000.00	2018	Shërbimet publike
46	Ndërtimi i Impiantit (tre vjeçar)	350,000.00	2018	Shërbimet publike
47	Ndërtimi i shtratit të lumit "Podrança me infrastruktur Sllatinë (tre vjeçar)	491,769.00	2018	Shërbimet publike
48	Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit	40,000.00	2018	Shërbimet publike
49	Ndërtimi i lapidarit për martirët e luftës së dytë botërore dhe luftës së UÇK-së	15,000.00	2018	Shërbimet publike
50	Rregullimi i shtratit të Lumit "Silnica" (tre vjeçar)	625,556.00	2018	Shërbimet publike
51	Ndërtimi i fushave sportive	26,000.00	2018	Arsimi

52	Meremetimi (Renovimi) i shkollave	100,000.00	2018	Arsimi
53	Ndërtimi i shkollës fillore në fshatinë Stanoc i Epërm (tre vjeçar)	300,000.00	2018	Arsimi
54	Ndërtimi i shkollës fillore në fshatinë Beçuk	87,405.00	2018	Arsimi
55	Ndërtimi i puntorisë dhe kabineteve në shkollën e mesme teknike	20,000.00	2018	Arsimi
56	Renovimi i QMF-ve dhe instalimi i ngrohjeve qendrore me pelet	67,000.00	2018	Shëndetësia
57	Renovimi dhe adaptimi i dy zyreve	3,000.00	2018	Shëndetësia
58	Ndërtimi i aneksit të qendrës rezidenciale	10,000.00	2018	Qendra rezidenciale Lum Madh
59	Renovimi i stadiumit të Hendbollit "Musa Abazi"	30,000.00	2018	Kultura
60	Ndërtimi i fushës ndihmëse të stadiumit të futbollit	30,000.00	2018	Kultura
61	Renovimi i stadiumit të futbollit (dy vjeçar)	60,000.00	2018	Kultura
62	Ndërtimi I kullës së UÇK-së në fshatinë Zhilivodë (dy vjeçar)	40,000.00	2018	Kultura
63	Rregullimi i kulmit, ngrohëjes qendrore dhe ventilimi të palestrës së sporteve (dy vjeçar)	120,000.00	2018	Kultura
64	Rregullimi I lumenjeve dhe argjinaturave	20,000.00	2018	Ekonomi-bujqësi
65	Projektet me bashkfinancim me donatorë (bujqësi)	50,000.00	2018	Ekonomi-bujqësi
66	Rregullimi i varrezave	15,000.00	2018	Shërbimet publike
67	Ndërtimi i lapidarëve	30,000.00	2018	Shërbimet publike
		7.554.915,00€		

KONKURSI PROJEKTIMIT

Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	Vlera e parashikuar e kontratës	Data e fillimit	Bartës i aktivitetit
1	Harta zonale	100.000,00 €	2018	Drejtoria e Urbanizmit
		100.000,00€		

❖ Administratë

Objektivat:	Aktivitetet	Afati i zbatimit	Përgjegjës	Mbështetës	Kostoja totale	Produkti
- Shërbime administrative kualitative, të qasshme, të bazuara në procedura administrative të arsyeshme dhe duke përdorur metodat e e- qeverisjes të orientuara kah nevojat e qytetarëve dhe bizneseve.	Identifikimi i shërbimeve administrative që ofrohen nga Komuna.	janar 2018	Drejtorit ë/Zyra	Kryetari i komunes		Lista mbi ofrimin e shërbimeve për secilën drejtori
